

S2 Albania sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 20

S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

AKTIVE	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	58,867,531	19,586,364
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	76,011,936	-
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		-	192,488
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	18,258,809	4,961,475
Shpenzime të shtyra	7	274,985	-
Total Aktive Afatshkurtra		153,413,261	24,740,327
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	8	1,207,050,056	402,505,259
Të tjera llogari të arkëtueshme	9	3,200,459	-
Total aktive afatgjatë		1,210,250,515	402,505,259
Total Aktive		1,363,663,776	427,245,586
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	33,724	-
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	1,288,223,167	394,084,875
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	12	17,297,806	399,806
Detyrime tatimore	13	2,267,670	877,601
Provizione	14	2,463,758	2,463,758
Të tjera detyrime	15	585,079	2,200,804
Total Detyrime afatshkurtra		1,310,871,204	400,026,844
Detyrime afatgjatë			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	16	185,537,857	157,595,609
Total Detyrime afatgjatë		185,537,857	157,595,609
Totali i detyrimeve		1,496,409,061	557,622,453
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	17	1,000	1,000
Fitime të mbartura		(130,377,867)	(18,556,361)
Fitimi i ushtrimit		(2,368,418)	(111,821,506)
Total kapitali aksionar		(132,745,285)	(130,376,867)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,363,663,776	427,245,586

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	208,123,399	
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	(55,755,445)	(44,030,675)
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(80,448,590)	(32,700,224)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe			
1) shpenzime të tjera	20	(40,595,337)	
2) Të tjera shpenzime	21	(39,853,253)	(32,700,224)
Shpenzime te personelit	22	(47,657,038)	(31,776,920)
1) Paga dhe shpërblime		(43,038,581)	(28,746,652)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(4,618,457)	(3,030,268)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(20,250,854)	(2,109,849)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(346,059)	(2,573,000)
Të ardhura të tjera			
Shpenzime financiare	24	(6,033,831)	1,369,162
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme			(903)
2) Shpenzime të tjera financiare		(6,033,831)	1,370,065
Fitimi/humbja para tatimit		(2,368,418)	(111,821,506)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24		
Fitimi/humbja e vitit		(2,368,418)	(111,821,506)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(2,368,418)	(111,821,506)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i nënshkruar	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2014	1,000	(18,556,361)	(18,555,361)
Fitimi / Humbja e vitit		(111,821,506)	(111,821,506)
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	1,000	(130,377,867)	(130,376,867)
Fitimi / Humbja e vitit		(2,368,418)	(2,368,418)
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	1,000	(132,746,285)	(132,745,285)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i më 24.03.2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Jonathan Flerding
Administrator



S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(2,368,418)	(111,821,506)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	6,879,023	93,921
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	20,250,854	2,109,849
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(120,534,474)	(5,121,878)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	940,402,333	396,530,104
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(1,615,725)	2,200,804
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	843,013,593	283,991,294
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(824,795,651)	(403,009,863)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(824,795,651)	(403,009,863)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	21,908,417	137,902,783
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	21,908,417	137,902,783
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	40,126,359	18,884,214
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	19,586,364	2,166,137
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(845,192)	(1,463,987)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 58,867,531	19,586,364

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "S2 Albania" është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 22.05.2013.

Kapitali i shoqërisë "S2 Albania" sh.p.k është 1,000 lekë, i ndarë në 1,000 kuota me vlerë nominale 1lek të zotëruara nga ortakët si më poshtë:

- Shoqëria "Rapiscan Systems Inc" zotërues i 510 kuotave ose 51% të kapitalit të shoqërisë
- Shoqëria "ICMS" zotërues i 490 kuotave ose 49% të kapitalit të shoqërisë

Administrator i shoqërisë "S2 Albania" është z.Jonathan Fleming.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është zbatimi i marrëveshjes së koncesionit në lidhje me skanimet e mallrave të importuara, automjeteve, kontenjerëve etj në pikat doganore Shqiptare si dhe cdo aktivitet tjetër lidhur me këtë ose i kërkuar për të realizuar zbatimin e marrëveshjes. Shoqëria ka të drejtën të kryejë cdo transaksion si veprimtari tregtare, financiare, qiradhënie, qiramarrje etj që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për arritjen e objektit të lartpërmendur të shoqërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: "Rruga Egnatia Nr 21, Kasharë – Tiranë
Ajo është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT L31722010Q.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 68 punonjës (2014: 22 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime

dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

i. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

ii. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

b. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

a. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

a. Transaksionet në monedhë të huaj

drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/ALL	137.28	140.14
USD/ ALL	125.79	115.23

b. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zëri i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

a. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

b. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

c. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

d. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

e. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

f. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

g. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

h. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

i. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Mjete monetare ne banke		
Banka ne Leke	1,514,567	145,832
Banka ne EUR	52,867,585	514,522
Banka ne USD	4,334,450	18,926,010
Arka	150,929	
Totali	<u>58,867,531</u>	<u>19,586,364</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	76,011,936	-
Totali	<u>76,011,936</u>	<u>-</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Shteti – TVSH për tu mare	18,258,809	2,463,758
Granci per Qera	-	2,497,717
Totali	<u>18,258,809</u>	<u>4,961,475</u>

7. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Shpenzime per siguracione	274,985	-
Totali	<u>274,985</u>	<u>-</u>

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

8. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Instrumenta Pune	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	-	-	1,605,244		1,605,244
Shtesa	394,084,875	7,240,068	1,684,921			403,009,864
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	394,084,875	7,240,068	1,684,921	1,605,244	-	404,615,108
Shtesa	812,340,298	10,088,483	616,296	241,193	1,509,381	824,795,651
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	1,206,425,173	17,328,551	2,301,217	1,846,437	1,509,381	1,229,410,759
<i>Zhvlërësimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013						-
Amortizimi i vitit		1,357,513	351,025	401,311		2,109,849
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	-	1,357,513	351,025	401,311	-	2,109,849
Amortizimi i vitit	17,939,359	1,680,935	281,457	309,024	40,079	20,250,854
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	17,939,359	3,038,448	632,482	710,335	40,079	22,360,703
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	-	-	1,605,244	-	1,605,244
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	394,084,875	5,882,555	1,333,896	1,203,933	-	402,505,259
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	1,188,485,814	14,290,103	1,668,735	1,136,102	1,469,302	1,207,050,056

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

9. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Garanci për qera	3,200,459	-
Totali	<u>3,200,459</u>	<u>-</u>

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Furnitore vendas	33,724	-
Totali	<u>33,724</u>	<u>-</u>

11. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Tregetare ndaj Rapiscan UK	1,287,925,045	394,084,875
Tregetare ndaj OSI Corporate	298,122	-
Hua ndaj Rapiscan UK	-	-
Totali	<u>1,288,223,167</u>	<u>394,084,875</u>

12. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Shpenzime per fatura te pa mberitura	12,266,206	399,806
Shpenzime per sherbime teknike	5,031,600	-
Totali	<u>17,297,806</u>	<u>399,806</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Tatimi mbi te ardhurat personale	817,265	395,554
Sigurime shoqerore & shendetesore	1,450,405	482,047
Totali	<u>2,267,670</u>	<u>877,601</u>

14. Provizione

Provizionet afatshkurtra dhe afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen në tabelen e mëposhtme:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
<i>Balanca ne celje</i>	2,463,758	-
Provizioni i periudhes	-	2,463,758
<i>Balanca ne fund</i>	<u>2,463,758</u>	<u>2,463,758</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 për bëhen nga detyrimet për pagat e punonjësve dhe detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Paga ndaj personelit	585,079	2,200,804
Totali	<u>585,079</u>	<u>2,200,804</u>

16. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Hua ndaj Rapiscan UK	185,537,857	134,127,517
Hua ndaj Rapiscan USA		23,371,326
Hua ndaj ndaj OSI Corporate		96,766
Totali	<u>185,537,857</u>	<u>157,595,609</u>

17. Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë "S2 Albania" sh.p.k është 1,000 lekë, i ndarë në 1,000 kuota me vlerë nominale 1lek të zotëruara nga ortakët si më poshtë:

- Shoqëria "Rapiscan Systems Inc" zotërues i 510 kuotave ose 51% të kapitalit të shoqërisë
- Shoqëria "ICMS" zotërues i 490 kuotave ose 49% të kapitalit të shoqërisë

Gjatë vitit 2015 nuk ka pasur ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Ta ardhura nga sherbimi I skanimit	208,123,399	-
Totali	<u>208,123,399</u>	<u>-</u>

19. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Fitime nga kursi I këmbimit nga aktiviteti I shfrytezimit	84,627,486	43,086,568
Humbje nga kursi I këmbimit nga aktiviteti I shfrytezimit	(140,382,931)	(85,747,178)
Totali	<u>(55,755,445)</u>	<u>(42,660,610)</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	208,123,399
Autofatura	
Parapagime	
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	<u>208,123,399</u>
Shitje punimesh & shërbimesh	208,123,399
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	<u>208,123,399</u>
Fitim nga këmbimet valutore	84,627,486
Total të ardhura të deklaruara në FDP e Tatim Ftimit	<u>292,750,885</u>

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Shërbime nga të tretë	23,324,393	-
Shërbime teknike	5,031,600	-
Tarifa e koncensionit	4,162,468	-
Shpenzime trainimi punonjësit	2,005,100	-
Uniforma për punonjësit	2,404,285	-
Shpenzime për karburant makinat	1,351,624	-
Materiale të konsumueshme	519,805	-
Qera makina	153,180	-
Shpenzime dosimetri dhe kalibrimi	186,899	-
Shpenzime transporti	989,580	-
Mirëmbajtje dhe riparime pajisjet	466,403	-
Totali	40,595,337	-

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Shpenzime qeraje	21,408,415	20,254,647
Siguracione	2,416,515	2,621,966
Konsulenca ekonomike, juridike etj	5,006,386	1,425,616
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	4,450,483	4,678,571
Shpenzime për pritje	190,640	-
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,270,421	1,332,311
Komisione bankare	162,708	156,416
Energji elektrike, ujë	2,301,508	917,373
Mirëmbajtje dhe riparime	535,681	74,170
Kontroll i detyrueshëm mjeksor	-	316,425
Materiale të konsumueshme	761,728	732,719
Taksa Lokale	25,120	25,420
Taksa dhe kontroll teknik makinat	432,344	-
Kancelari	130,082	-
Shpenzime administrative	2,062	15,729
Shpenzime marketingu dhe publiciteti	515,208	-
Shpenzime rekrutimi	235,593	-
Shpenzime të tjera	8,359	148,861
Totali	39,853,253	32,700,224

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Paga dhe shpërblime	43,038,581	28,746,652
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	4,618,457	3,030,268
Totali	47,657,038	31,776,920

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penaltetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Gjoha dhe penaltete	10,000	109,242
Provizion	-	2,463,758
Mbyllje te drejta te pa arketuar	336,059	-
	346,059	2,573,000

24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Shpenzime per interesa	-	(903)
Humbje nga kembimet valutote	(6,033,831)	-
Fitime nga këmbimet valutore		1,370,065
	(6,033,831)	1,369,162

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
<i>Fitimi para tatimit</i>	(2,368,418)	(111,821,506)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	12,003,407	7,219,493
Shpenzime pritje & percjellje	162,700	6,740
Shpenzime udhëtimi	2,662,947	
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	10,000	109,242
Sherbime teknike ne proces per shmangjen e Tatimit ne Burim	5,031,600	
Shpenzime amortizimi mbi normen tatimore		341,708
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)		2,463,758
Shpenzime të tjera	4,136,160	4,298,046
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	9,634,989	(104,602,013)
Humbje fiskale e mbartur nga 2013	(9,634,989)	
Rezultati fiskal	-	(104,602,013)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-	
Rezultati I vitit	(2,368,418)	(111,821,506)

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

26. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Rapiscan UK	1,473,462,902	528,212,392
Rapiscan USA		23,371,326
OSI Corporate	298,122	96,766
Totali	<u>1,473,761,024</u>	<u>551,680,484</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Blerje		
Rapiscan UK	813,785,710	394,084,875
Rapiscan USA	455,570	
OSI Corporate	1,689,882	19,282
ICMS	23,324,393	
Totali	<u>839,255,555</u>	<u>394,104,157</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

27. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2015, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.